VENDIM
Nr. 332, datë 16.5.2012

PËR PAGESËN E SHËRBIMEVE JURIDIKE PËR PËRFAQËSIMIN DHE MBROJTJEN NË ÇËSHTJEN E ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR NR. ARB/11/18 "BURIMI S.R.L. & EAGLE GAMES, SHA, KUNDËR REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t'i shtohet fondi 70 000 (shtatëdhjetë mijë) euro, për të përballuar pagesat e tarifave avokatore të përfaqësimit (kësti i parë), për çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar "Burimi s.r.l. & Eagle Games, sh.a., kundër Republikës së Shqipërisë", që zhvillohet në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve në Investime (ISCID).

2. Ky fond, i konvertuar në lekë me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën kur do të kryhet pagesa, i transferohet Ministrisë së Drejtësisë për të bërë pagesën.

3. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha